



V-d

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi
në ILDKPKI
dhe Viti

2017

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
PERIODIK / VJETOR

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklaram të interesave private të tij, të bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014 dhe Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Emri

TOMI

Atësia

ILIRI

Mbiemri

FRASHERI

Funksioni

KESHILLTAR I KRYEMINISTRIT

Institucioni dhe adresa

KRYEMINISTRIA, BUL. DESHMORET E KOMBIT, TIRANE

Data e emërimit në funksionin që kryen

1.09.2014

Data e dorëzimit të deklaratës

29 MARS 2018

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

TOMI FRASHERI

**NDRYSHIMET E PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.


Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Pasuria në Tiranë me numër [redacted] në zonën kadastrale [redacted] Kati I i një shtëpie përbërë nga dy dhoma, një guzhinë, një aneks, një sallon, një wc, me dalje në rrugë publike me portë dhe bodrum, 121m ² . Trashëgimi familjare.	E pandryshuar	33.3
2.	Pasuria në Tiranë me numër [redacted] në zonën kadastrale [redacted] truall (oborr) me sipërfaqe 57,5m ² . Trashëgimi familjare.	E pandryshuar	33.3
3.	Apartament banimi, sip 101.37 m2, rruga [redacted] nr. [redacted] Tirane, blere ne janar 2017. Burimi i krijimit: Kredi nga [redacted] Bank 70.000 euro Dhurate per martesë cash personale nga te ftuarit per te dy bashkeshortet 1.360.000 lek bashkeshortja dhe 1.250.000 lek (nje milion e dyqind e pesedhete mije lek) deklaruesi, gjithsej 2.610.000 lek ose 20.000 euro Kursime cash personale bashkeshortja, 7.370 euro. Huamarrje pa interes bashkeshortja, 4000 euro	101.370 euro (njqint mije euro)	50%
4.	Llogari e pages ne [redacted] Bank gjendje date 31.12.2017	162.527 lek (njeqint e gjashtedhete e dy mije e peseqint e njezet e shtate lek)	100
4.	Llogari bankare e pages/honorarit ne [redacted] Bank gjendje ne date 31.12.2017	46.231 lek (dyzet e gjashte mije e dyqint e tridhete e nje lek)	100

* **Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit

TOMI FRASHËRI




**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET
NË VEPRIMTARI
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa , nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
1- Te ardhura neto nga paga per periudhen 1.1.2017- 31.12.2017 ne Kryeministri	1.378.302 Lekë (Një milion e treqint e shtatedhjetë e tete mijë e treqint e dy lekë)
2- Të ardhura neto nga paga për janar 2017-gusht 2017 si anëtar i këshillit drejtues të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare	102.000 Lekë (Njëqint e dy mijë lekë)
3- Te ardhura neto te bashkeshortes nga paga per periudhen janar 2017- shtator 2017 ne Kryeministri	912.259 lek (nenteqint e dymbeshjete mije e dyqint e pesedhjetë e nente lek)
4- Te ardhura nga honorar per vitin 2017 te bashkeshortes si Kryetare e Keshillit mbikqyres ne Sh.a:Trajtim Studenti Nr.2” 1.1.2017-31.12.2017	281.642 lek (dyqint e tetedhjet e nje mije e gjashteqint e dyzet e dy lek)
5. Te ardhura neto nga paga e bashkeshortes per periudhen 11.9.2017- 31.12.2017 ne Drejtorine e Sherbimeve Qeveritare	401.037 lek (katerqint e nje mije e tridhjetë e shtate lek)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit

TOMI FRASHËRI



**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**


- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura nga zyrtari gjatë vitit të deklarimit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr.7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)
Kredi per apartament banimi, sip 101 m2, rruga [redacted] nr. [redacted] Tirane, blere ne janar 2017 me shumen kredi ne [redacted] Bank 70.000 euro dhe kredi per blerje apartamenti banimi me sip.67 m2 ne [redacted] BANK 20.6.2014, blere ng [redacted] BANK ne janar 2017 me shumen 52.000 euro me afat 25 vjet, bashkuar ne nje kredi me shumen 122.000 euro	122.000 euro (njeqind e njezet e dy mije euro)	118.842 euro (njeqind e tetembedhjete mije e teteqind e dyzet e dy euro)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit
TOMI FRASHËRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi
në ILDKPKI

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
E PERSONIT TË LIDHUR

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklaram në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ” i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ” i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/sja **DHURATA VANGJEL FRASHËRI**, bashkëshorti/ja
Emër, Atësi, Mbiemër fëmijë madhorë së bashku me prindërit
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit
bashkëjetuesi/ja

i/e Subjektit **TOMI ILIR FRASHËRI**
Emër, Atësi, Mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

DHURATA FRASHËRI

**NDRYSHIMET E PASURIVE
DHE BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni, të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të viti të deklarimit.


Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Apartament banimi, sip.67 m2, rr. [REDAKTUAR], Tirane, blere ne qershor 2014.	E pandryshuar	100
2.	Apartament banimi, sip 101.37 m2, rruga [REDAKTUAR], nr [REDAKTUAR] Tirane, blere ne janar 2017. Burimi i krijimit: Kredi nga [REDAKTUAR] Bank 70.000 euro Dhurate per martesë cash personale nga te ftuarit per te dy bashkeshortet 1.360.000 lek (bashkeshortja dhe 1.250.000 lek (nje milion e dyqind e pesedhete mije lek) bashkeshorti gjithsej 2.610.000 lek ose 20.000 euro Kursime cash personale bashkeshortja 7.370 euro. Huamarrje pa interes, 4000 euro.	101.370 euro (njeqint mije euro)	50
3.	Kursime cash personale	E ndryshuar 300.000 lek (treqint mije lek)	100
4.	Llogari bankare e pages ne [REDAKTUAR] bank gjendje ne date 31.12.2017	4.758 lek (katerrmije e shtateqint e pesedhete e tete lek)	100
5.	Llogari bankare depozite plus ne [REDAKTUAR] Bank gjendje ne date 31.12.2017	E ndryshuar 450.670 lek (katerqint e pesedhete mije e gjashteqint e shtatedhete lek)	100
6.	Llogari bankare e pages/honorarit ne [REDAKTUAR] Bank gjendje ne date 31.12.2017	154.837lek (njeqint e pesedhjet e kater e teteqind e tridhete e shtate lek)	100

*Objekti i deklarimit (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur
DHURATA FRASHËRI**



**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË
VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe në tregëtimit të vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa , nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
1. Te ardhura neto nga paga per periudhen 1.1.2017- 11.9.2017 ne Kryeministri	912.259 lek (nenteqint e dymbeshjete mije e dyqint e pesedhjete e nente lek)
1. Te ardhura nga honorar per vitin 2017 si Kryetare e Keshillit mbikqyres ne Sh.a:Trajtim Studenti Nr.2” 1.1.2017-31.12.2017	281.642 lek (dyqint e tetedhjet e nje mije e gjashteqint e dyzet e dy lek)
2. Te ardhura neto nga paga per periudhen 11.9.2017- 31.12.2017 ne Drejtorine e Sherbimeve Qeveritare	401.037 lek (katerqint e nje mije e tridhjetete e shtate lek)

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura gjatë vitit të deklarimit..
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr.11, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)
Kredi per apartament banimi, sip 101 m2, rruga [redacted] [redacted] irane, blere ne janar 2017 me shumen [redacted] kredi ne [redacted] Bank 70.000 euro dhe kredi per blerje apartamenti banimi me sip 67 m2 ne [redacted] BANK 20.6.2014, blere nga [redacted] BANK ne janar 2017 me shumen 52.000 euro me afat 25 vjet, bashkuar ne nje kredi me shumen 122.000 euro	122.000 euro (njqind e njezet e dy mije euro)	118.842 euro (njqind e tetembedhjete mije e teteqind e dyzet e dy euro)
Huamarrje pa interes , 4000 euro.	0 euro (zero euro)	4000 euro (katermije euro)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur
DHURATA FRASHËRI**



Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në dy ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligj nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

Deklarimi i interesave private nga zyrtari

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private priodik/vjetor” duhet të plotësohet nga zyrtari në funksion, por **edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më pak se një vit nga funksioni i mëparshëm.**
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimin financiar të subjektit.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter). Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkesave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.
- Subjekti/zyrtar nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, deri më **31 Mars** të çdo viti.

Bashkëlidhur Deklarimit të interesave private zyrtari duhet të dorëzoj: kopje të Letër Njoftimit (Kartës së Identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.

Për fëmijët e tjerë zyrtari duhet të dorëzoj fotokopje të Pasaportës ose të Çertifikatës personale.

Mosplotësimi i këtij detyrimi passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI

dhe për pasojë ndaj zyrtarit do të aplikohen sanksione për refuzim të deklarimit të interesave private.

Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, **për pasuritë që disponojnë veçmas.**
- Subjekti/Personi i lidhur me zyrtarin, (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore) i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, subjekti deklarues personi i lidhur është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës “AUTORIZIMI”, ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar
- Për mosdeklarim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, deklaruesi dënohet me gjobë nga 50.000 lekë deri në 100.000 lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklarimit duhet të nënshkruhen nga deklaruesi në të kundërt, deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e pa dorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme apo asistencë në plotësimin e deklaratës, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me “Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse” në numrat e telefonit **042 259 461**, Falas 08009999, info@hidaa.gov.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.